

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-31

M 78

Piro Minguli

NË
QYQTETIN
ME ERË
TE FORTË

tregime e skica

814-34
1748

PIRO MINGULI

NË
**QYTETIN
ME ERË
TË FORTË**

tregime e skica



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

SHTËPIA NË MES TË QYTETIT

Ai erdhi me dhjetë minuta vonesë. Dy bojaxhinjtë e tjerë kishin bërë gati çdo gjë dhe prisnin ardhjen e tij. Ishin mbështetur te muri i zyrate të komunales dhe shihnin shtëpitë e qytetit, më të shumtë të porsalyera, që ndrisnin të pastra atë mëngjes të tejdukshëm marsi.

Ndihmësbojaxhiu Qani tha një «mirëmëngjesi» të thatë, me një tingull të huaj për zërin e tij e u përkul për të marrë pompën.

— E kishim lënë të vinim herët sot, — tha Ladi, ndihmësbojaxhiu tjetër, një djalë rrëth të nëntëmbëdhjetave, me trup të gjatë e të hollë. Ustai dhe Ladi vështruan Qaniun, po pati vetëm një heshtje të zgjatur dhe asnjë lloj përgjigjeje.

— Ikim, — tha ustai, duke lëvizur nga muri ku që mbështetur. Ata morën pompën, kovat, bojën e u bënnë gati për rrugë.

— Kemi punë shumë sot, — tha përsëri Ladi, ndërsa kalonin pragun e oborrit të komunales.

— Është ditë e bukur e do të na vejë mbarë, — tha ustai. Ndihmësi tjetër, Qaniu, një burrë rrëth të pesëdhjetave ecte me kokën ulur. E dinte që atë

ditë duhej të qe i heshtur. I heshtur dhe i shurdhët. Po të qe e mundur dhe i verbër. S'duhej të fliste, s'duhej të dëgjonte, s'duhej të shihte. Do të mundohej, në të gjitha mënyrat, të bëhej i tillë. Do të bënte si të bënte e do të duronte gjithçka pa folur. Ishte i detyruar të bënte kështu.

Djali filloj të vërshëllente melodinë e një këngë të re, që qe bërë e njohur e që ia kishin mësuar një grup të rinjsh, të ardhur nga hekurudha Tiranë-Durrës. Ai e vërshëllente gjithë qejf dhe kjo vërshëlli-më ia ngacmonte nervat Qaniut po ashtu si biseda e mëparshme, po... kishte vendosur të heshtte, të mos dëgjonte, të mos shihte. Rregulloj më mirë pompën në kurriz dhe vazhdoi rrugën. Kur arritën pranë shtëpisë që do të lyenin atij iu prenë këmbët. Ndjeu një drithërimë të menjëherershme e si një farë ngri-rjeje gjaku a fitohje damarësh e iu duk se s'do të mbante dot peshën e trupit e të pompës, po do të shembej papritur në kalldrëm. Po s'ndodhi asgjë. Ai vazhdoi të ecte dhe e shihte se po i afrohej gjithnjë e më tepër shtëpisë. Kjo e tmerroi disi dhe zvogëloj hapat, duke mbetur më pas se dy të tjerët. Pastaj u kujtua se s'duhej ta jepte veten dhë u mundua të shpejtonte të ecurit e të bashkohej me të parët. Nuk duhej në asnjë mënyrë që ata të dallonin shqetësimin e dobësinë e tij.

Shtëpia që do të lyhej ndodhej pothuajse në qendër të qytetit, ishte e madhe, dykatëshe e me shumë dhoma. Kishte një ballkon të gjatë e të bukur, tarracë të lartë dhe një oborr të gjerë me lule të shumëllojshme.

Bojaxhinjtë vendosën në oborr pompën dhe kovat dhe hodhën një vështrim si për të matur me sy shtëpinë.

— S’mbarojmë dot sot. Është gjithë kjo! — tha i dëshpëruar Ladi.

— Shtëpi e bûkur, — tha ustai, të cilit, ngaqë e thërrisinin vazhdimisht kështu, gati ia kishin harruar emrin dhe vështroi Qaniun. Qaniu e ndjeu këtë shikim dhe uli sytë. Nuk duhej të shihte, ishte i verbër.

— Për mua kjo është më e mira në qytet, — tha djali.

— Duhet të jenë bërë fli nja 3 milionë në themel të saj, — tha përsëri ustai pa ia ndarë sytë Qaniut.

— Sa?! — u habit djali.

Po ustai u tha të përgatisnin bojën se s’duhej të humbisnin asnjë minutë kohë. Kishin shumë punë.

Qaniu mërmëriti nëpër dhëmbë e mori kovat për të mbushur ujë. Mendoi njëherë se do të kishte bërë më mirë që të mos vinte. Të nxirrte një shkak. Të sëmurej a t'u kishte thënë se kishte një kushëri gati për vdekje. Të kishte gjetur një rrugëdalje. Njerëzit përsëri do të flisnin për të. Megjithatë dhe kështu ishte torturuese. Çdo gjë, fjalët e dy bojaxhinjve të tjerë, shtëpia, pompa, boja, gjithçka ishte e rëndë dhe tmerruesë. Po duhej të duronte. Kiske vendosur. Ishte shurdh, memec dhe i verbër. Ai ikte e vinte nëpër oborr, nga pusi ku mbushte ujë gjer te fuçi ka ku përgatisnin bojën ustai me Ladin.

Disa vjet më parë, ai nuk quhej kështu Qani, siç mund të quhet «një dru, një mace në shtëpi a një gjë çfarëdo.» Nuk thirrej as kështu thjesht ndihmës-bojaxhi. Jo. Disa vjet më parë ai ishte zoti Qani, tregtar me zë në qytet e përtej kufijve të tij, që e cte fodull e hijerëndë rrugëve. Para pushtimit të vendit nga Italia ishte një tregtar fare i rëndomtë, me një

pasuri fare të vogël, po më pas, gjatë Luftës arriti të nxirrte shuma të mëdha, aq sa ndonjëherë habitej dhe vetë. Kur mbaronte së bëri llogaritë, kur nxirrte me bojë të kuqe fitimet, shkrihej i téri nga kënaqësia dhe uronte që të kishte sa më shumë të varfër. Njerëzit e thjeshtë, të cilët lufta i bëri dhe më hallexhinx nga çishin, më të këputur e nevojtare, detyroheshin që me varférinë e tyre të pasuronin zotin Qani.

Një shtëpi e bukur kishte qenë dëshira e tij më e madhe. Kishte parë katalogje të shumta, nga më të ndryshmet e, më në fund, pas luhatjesh e mëdyshjesh të shumta kishte vendosur për modelin. Porosi- ti qdo gjë në Itali. Madje dhe muratorët i mori itali- anë, mbasi kishte dëgjuar se qenë ndërtues të mirë. I kishte paguar shtrenjtë, që të punonin me merak dhe sipas qejfit të tij. Donte një shtëpi të bukur, të madhe e të fortë, që të qe simbol i përher- shëm i pasurisë dhe forcës së vet. Zoti Qani ishte i pasur e kjo duhej të shquhej jo vetëm në emrin e tij, më veshjen e më hijen e tij por dhe më këtë shtëpi të lartë, që do të binte më sy mbi të gjitha shtëpi- të e tjera përdhese. Pastaj donte t'u tregonte zonjës së kryetarit të bashkisë, zonjës së nënprefektit, të tregtarëve të tjerë se ç'shihe të lartë kishte ai, zoti Qani, një burrë shtatmesatar, me fare pak kultu- rë, po ama i rafinuar më tregti.

Gjatë kohës që ndërtohej shtëpia ai kishte jetuar më një ankth të madh. Kishte një padurim tor- turues e mezi priste të mbarohej shtëpia, të ndër- tohej e ai të ulej tërë pompozitet më kollluqet e the- lla prej meshini të zi. Kjo shtëpi nuk qe thjesht një trill, por një kërkësë e dëshirueshme dhe e domos- doshme për një tregtar hijerëndë. Pastaj kjo gjë do

t'i shtonte rëndësinë e emrit, bukurinë e trupit dhe rrëthin e miqve nga shoqëria e lartë. Ata do të mbildheshin në mbrëmje në sallonin e katit të dytë, do të fundoseshin në kolltuqet e trasha e me gotat e kristalta në dorë do të filozofonin për jetën, luftën, qeverisjen. Do të talleshin me rreckamanët që vriteshin për liri, do të qeshnin, do të vallëzonin, e zoti Qani do ta ndiente veten të llumturuar sa s'kishte ku të vente më.

Mobiljet, orendifitë, abazhurët, çdo gjë të nevojshme për një komoditet luksoz, i kishte porositur vetë në Itali. Kishte kohë që zoti Qani jetonte vetëm për këtë shtëpi. Ajo tashmë qe kthyer në një pasion, ash-tu si tregtia, si numërimi i parave. Ai numëronte ditët që duheshin gjer në mbarimin e shtëpive, gjer atë ditë, atë orë, kur do të hapeshin dyert e lyera bukur e për të parën herë mbi pllakat e mermerta të korridorit të gjatë, mbi qilimin e trashë persian, në sallonin e pritjes, kudo, në çdo kënd të shtëpisë, do të shkelnin hapat e zotit Qani, krenar e pompoz. Për disa ditë ai do të bëhej qendra e bisedave në të gjitha shtëpitë e pasura, në kafenetë e hotelet e qytetit. Emri i tij do të përmendej me qindra herë nga zëra të hollë e të lajkatuar grash, nga zëra disi nervozë e tërë smirë burrash. Megjithatë, për të kishte rëndësi që emri i tij do të lëvizte përmes kushedi sa buzëve të holla e të trasha. Atë ditë ai do të qe një kalë i bukur, i fuqishëm, që iikën fluturimthi, në lëndina, kodra, kopshët, pyje. Zoti Qani, në pagjumi-sinë e qytetit, në ëndrrën e tregtarëve më të vegjël, në urrejtjet e konkurentëve, në buzëqeshjet e zonjave. Të paktën këtë gjë mendonte ai, duke harruar se do të kishte shumë më tëpër që do ta përmend-nin emrin e tij me urrejtje, me përbuzje e neveri...

— Shtëpia ka 10 dhoma, dy korridore të gjata e të larta, dy banja, tri anekse e një sallon në katin e dytë. Kemi punë boll, — tha ustai duke vështruar shtëpinë.

— Ke qenë herë tjetër në këtë shtëpi? — pyeti Ladi.

— Jo, po kam dëgjuar për të atëherë kur ndërtohej. Gjithë qyteti për këtë fliste. Mua më duke-shin gjëra të pabesueshme, sepse qeshë mësuar me rrugicën e shtëpive tonë, ku flnim 5 vete në një dhomë e natën nuk rrrotulloheshim dot se zgjonim tjetrin. Më vinte çudi që dy njerëz do të kishin kaq shumë dhoma.

Ustai vështroi Qaniun, që ikte e vinte me kovat e ujit ashtu si gjithnjë i heshtur.

— Mbushni pompën, — tha pastaj ustai. — Fillojmë nga lyerja.

Lyerjen e filluan nga korridori. Ustai lyente, kurse Qaniu i jepte pompës.

— Jepi më shpejt, — tha ustai nga qoshja e korriderit. Qaniu qortoi veten që kishte lejuar të kuptohej turbullimi i tij. Në brendësi ky turbullim kishte nisur që gjatë natës, në përpjekjet e vazhduese shme për të fjetur, pastaj në paraqitjen me vonesë në punë apo dhe pak më parë gjatë rrugës, ku ndihet si i dehur dhe hapat i hidhte si në èndërr, ja dhe tani pompën e lëvizte krejt pa vetëdije. U përmend nga fjalët e ustait dhe lëvizi duart më shpejt. Gjer atëherë s'kishte vënë re asgjë. Ishte si mes një mjegulle të dendur që s'e linte të shihët asgjë. Përpëlliti qepallat dhe u mundua të mësohej me errësirën e korridorit. Dalloj përmasat e vërteta. Të njëjtat mure, e njëjta lartësi. Ja dhe vija e gjelbër, 10 cm. nën tavanin e lartë. Vështroi poshtë. Pllakat

ishin përsëri të reja e të pastra; kishte shkelur kushëdi sa herë nëpër to. Psherëtiu dhe mbylli sytë. Nuk donte të shihte asgjë. Çdo gjë do të që e lodhshme, e rëndë e do t'ia shtonte atë dhembje të brendshme që e torturonte. Duart i lëvizte mekanikisht, pothuajse me sy mbyllur. Gjatë gjithë kohës që lyhej korridori, ustai s'tha asnje fjalë. Vazhduan kështu gjer në drekë, kur të lodhur u ulën në një qoshe të dhomës, ku njëra prej grave të familjes që banonte aty u solli për të ngrënë.

— S'mbarojmë dot sot! Gjithë këto dhoma! Kaq mure të larta! — tha disi i dëshpëruar e i habitur Ladi.

— Shtëpi pasaniku. Te pasanikët asnijëherë puna s'mbaron kollaj, — tha ustai, duke u mbillaçitur.

Qaniu hante në heshtje. Lëvizte me kujdes dorën që mbante lugën, duke u munduar të mos dukej asnje lloj dridhjeje. Ata mund të thoshin ç'të donin. Mund ta shanim, mund të talleshin, ta ironizinin. Ai do të heshtte. Ishte i shurdhët, dhe vazhdon te të hante me sytë ulur. Dhe atëherë në këtë dhomë hante... Dreka me një pjatë gjellë! Kjo qe tepër poshtëruese dhe qeshara ke. Atëherë... le kur shtroheshin drekat e darkat, mbushej tavolina me lloje të shumta gjellësh të kuzhinave të ndryshme evropiane. Atëherë ai do të queshte me të madhe ose do ta gjuante me shqelma po t'i vinin përparrë një pjatë të tillë, po tanë ishte i detyruar të hante në heshtje, madje me oreks, se kishte punuar shumë e do të punonte përsëri gjer natën vonë.

Gratë që u kishin përgatitur drekën, u sillnin bukë, ujë, i pyesnin nëse donin gjë tjetër. Qaniu mendonte se do të ndodhët diçka me të. Me siguri që ndonjëra prej grave e dinte se kush ishte ndihmës-

bojaxhiu Qani dhe kishte të drejtë të thoshte ç'të donte. Mbështetje do të shante, do të mallkonte, do të pështynte, a do të mblidhët buzët tërë neveri. Ai e priste këtë, sa herë që ato hynin për të sjellë ndonjë gjë, sa herë që bënин muhabet për shtëpinë e tyre të mirë e të bukur, për masat e reja që merrte pushteti popullor në interes të masave punonjëse, në urimet e tyre për këtë pushtet. I rrithnin tëm- that dhe damari në ballë i qe fryrë. Lëshoi një lloj hungërimë të brendshme tepër të lehtë dhe s'e dëgjoi askush.

Gratë ngritën pjatat dhe u sollën kafen. Ustai zgjati paketën dhe ata ndezën nga një cigare. Qani u rrinte si i tulatur. U trembej fjalëve të ustait. Po ai s'e ngau llafin dhe nga kjo Qani u habit disi. Që nga mëngjesi ustai qe munduar t'i tregonte atij, ish-zotit Qani, se koha e tij dhe e klasës së tij kishte vdekur. Ishte munduar ta bënte këtë me ironi. Po këtë gjë kishte thënë dhe heshtja e grave. Me të mbaruar cigaret, ustai buzëqeshi lehtë dhe, pasi falënderoi gratë për drekën, u tha shokëve të ngri- heshin.

— Do të fillojmë sallonin e katit të dytë, — tha qetë.

Ata ngritën shkallët, pompën, kovat dhe zunë të ngjiteshin në katin e dytë. Dikur mbi këto shkallë Qani kishte shkelur më përkujdesje, nëpër një rrugicë të bukur. I urdhëronte shërbyesit që të pastro- nin sa herë që diçkush kalonte nëpër shkallë. Rrugica plot push duhej të qe gjithmonë e butë dhe e pa- stër pér hapat e tij e të miqve të vet. Kurse tanë që po kalonte mbi shkallë me këpucët plot njolla të ndryshme boje, se si i dukej. Kapërceu pështymën dhe u mbajt pas parmakëve.